

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje kimikat për nevojat e shoqërisë për periudhën 2024-2026 “ ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kimikate për trajtimin e ujit 24962000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 450 000(nente milion e katerqind e pesedhjet mije)leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësja e Kanalizimeve Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikaten e origjines se mallit e cila duhet të permbushe STANDARTET EUROPIANE: **DIN 19602,EU 891/02.2023CAS No12410-14-9 (ose ekuivalente)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2020,2021 dhe 2022, ku vlera e perlllogaritur duhet të jete jo me e vogel se 40% te vleres se parashikuar te kontrates.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë **arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM ”Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti koonraktor per të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri

në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare të certifikuar nga organet tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. Si dhe Ligjin nr 8438 dt 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar ,ku theksohet ”Cdo tatim pagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuara ne Udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 20% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; **a)** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, **b)** Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur në vlerën limit të kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme,

mbështetur në sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë referencën për specifikimet teknike sipas standartit europian:

DIN 19602,EU 891/02.2023CAS No12410-14-9 (ose ekuivalente)

Operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë me shkrim në të cilën mer përsipër të kryejë shërbimin e transporti

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të paraqesë në dokumentat e tenderit një deklaratë që verteton faktin që mallrat do të sjellë pranë AK, pra nëpërmjet kesaj deklarate AK i lind e drejta të kerkoje që malli të vije pranë Ujesjelles Kanalizime sha Pogradec, dhe jo ta transportojë AK atë. Gjithashtu duhet të paraqesë referencën për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas standartit europian.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 mjet të autorizuar për transport kimikatesh për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Për sa me siper duhet të paraqesë :

)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende të rrezikshme”, lejen e qarkullimit, plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontratën perkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jënë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.c)Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorezimit të tyre në destinacionin perkates, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” të ndryshuar.*

Në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” parashikohet se

“Leje mjedisi e tipit A” është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

Përderisa tipi i lejes A përfshin në veprimtarinë e saj “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (2)” atëherë domosdoshmërisht operatori ekonomik prodhues i interesuar për procedurën objekt prokurimi duhet të jetë i licënsuar për prodhimin e kimikateve inorganike bazë me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin që derdhet në Liqen, me anë të vendosjes së ketyre kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Keto specifikime janë hartuar në përputhje me VKM Nr.177 date 31.03.2005 si edhe në zbatim të Lejes mjedisore

Komisioni